

MEHMET PASHË DERALLA NË GOJËDHËNA

Benjamin HASHANI

UDK: 929Дерала, М

Abstrakt

Në këtë hulumtim trajtohet jeta, vepra, kontributi dhe puna e Mehmet Pashë Derallës në themelimin e ushtrisë shqiptare dhe vendosjen e institucioneve shtetërore, ushtarake, policore në shërbim të atdheut dhe kombit shqiptar.

Një djalë nga fshati Gradec, vendbanim rrëzë Sharrit, ndërmjet Tetovës dhe Gostivarit, të cilin e kishte rritur e përkujdesur Mehmet Pashë Deralla, kishte përparuar aq shpejt në hierarkinë perandorake, sa që një ditë ishte bërë këshilltar personal i Sulltan Hamitit në Stamboll. Pikërisht ky këshilltar do t'i shpëtojë jetën Mehmet Pashës, në një konflikt për çështje rezistence kundrejt pushtetit osman. Sulltani ka dashur ta dënojë me vdekje Mehmet Pashë Derallën, ndaj dhe ka thirr këshilltarin e dytë të tij, pikërisht bonjakun e dikurshëm të Gradecit, për të cilin ishte kujdesur pashai i Tetovës. Sulltani e pyet për këshillë, kurse gradecasi do t'i thotë: "Nëse merrni një veprim të tillë, mund të ngrihet në këmbë e gjithë Tetova".

Mehmet Pashë Deralla vinte nga një familje shqiptare me tradita atdhetare e ushtarake të Hasan Derallës nga fshati Gradec i anës së Gostivarit, në vitin 1843. Arsimin fillor e kreu në Tetovë, kurse të mesmin në Shkup. Pas kësaj studioi në Akademinë e parë ushtarake turke të Stambollit, ku u diplomua oficer me rezultate të shkëlqyeshme. Shërbeu në një regjiment këmbësorie në Anadoll. Më pas studioi në Akademinë e Dytë ose në Shkollën e Lartë të Shtatmadhorisë. Në vitin 1878 fiton gradën gjeneral brigade dhe shërben për disa vite në vise të

Perandorisë turke, më pas kryen detyrën e komandantit të Vilajetit të Kosovës në Manastir dhe Shkup. Nga viti (1878-1881) mbështeti Lidhjen Shqiptare të Prizrenit në organizimin e forcave ushtarake të saj, së bashku me të atin e tij dhe kryente veprime luftarake kundër shovinizmit sllav. Pas shpërbërjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, angazhohet edhe në Kuvendin e Pejës, prej nga në vitin 1899 internohet në Bagdad. Këto janë disa nga karakteristikat që e shquajnë Mehmet Derallën nëpër periudhat historike. Është ministri i parë i Ushtrisë në historinë shqiptare.

Fjalë kyçe: Tetova, Shqipëria, mbrojtja e atdheut, sakrifica.

Disa fjalë për Mehmet Pashë Derallën

Mehmet Pashë Deralla u lind me 1843 në Gradec të Gostivarit, Maqedoni. Ai është regjistruar në memorien historike të popullit tonë si një ndër protagonistët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të vitit 1878. Ishte ministër i Luftës në Qeverinë e Përkohshme të Shqipërisë, të drejtuar nga Ismail bej Vlora. Roli i Mehmet Pashë Derallës në organizimin dhe drejtimin e kryengritjeve të mëdha të Kosovës të viteve 1910-1912 ishte shumë i madh, si një nga protagonistët kryesorë të qëndresës shekullore përballë sulmeve serbo-malazeze, të cilat synonin pushtimin e Shqipërisë veriore. Me shpalljen e Pavarësisë, më 28 nëntor 1912, Kuvendi i Vlorës shpalli edhe krijimin e Qeverisë së Përkohshme nën kryesinë e Ismail Qemalit, ndërsa Mehmet Pashë Deralla u zgjodh në postin e lartë, ministër i Luftës. Dita e festës kombëtare të ushtrisë, 4 dhjetor 1912, lidhet ngushtë edhe me emrin dhe kontributin e gjeneral Derallës.³⁵²

³⁵² <http://www.arkivalajmeve.com/Tre-ministra-shqiptare-te-Mbrojtjes-bashke-per-te-nderuar-ministrin-e-Luftes>.

Ai flaku të gjithë pasurinë e tij (gjerdanët, medaljet që i mori me mund dhe sakrificë pune dhe vështirësi, për të veshur petkun e atdhedashurisë, mëmë Shqipërisë dhe deri në fund të jetës së tij ia kushtoi çështjes kombëtare shqiptare.³⁵³

Mehmet Pashë Deralla as edhe një moment nuk pushoi së punuari për çështjen shqiptare, pa ndarje, si në Maqedoni, Kosovë e Shqipëri, për të vetmin qëllim atë të çlirimit të kombit shqiptar nga kthetrat barbare osmane. Mehmet Pashë Deralla ishte ushtarak karriere, që arriti gradën pasha (gjeneral) që në moshën 35 vjeçare. Ai ishte i përkushtuar dhe specialist në përmasa të një strategu ushtarak të përmasave të mëdha. Gjeneral Deralla shërbeu në disa funksione të larta shtetërore e ushtarake, brenda dhe jashtë hapësirës së vilajeteve shqiptare. Kudo ishte model i përsosmërisë ushtarake, profesionale, teorike dhe praktike.³⁵⁴

Kontributi i Derallës për ushtrinë shqiptare

Duhet të themi se plejada ushtarake më e zgjedhur nga sulltani dhe që shërbyen në oborrin e tij, pas pavarësisë u kthyen në vendin e tyre dhe shkrinë jetën e tyre për Shqipërinë. Pas shpalljes së pavarësisë, Ismail Qemali, duke i ditur aftësitë e tij organizative, luftarake, kombëtare, e vendosi në krye të ushtrisë shqiptare³⁵⁵. “Me pamje ishte shtatlartë, ishte i afërt me njerëzit që e rrethonin figurat e kombit. Ky, në bashkëpunim të ngushtë me kryetarin e qeverisë, Ismail Qemal Vlora, krijoi lidhje të ngushtë me patriotë nga të gjitha trevat shqiptare, si: Haxhi Zeka, Bajram Curri, Idriz Seferi, Isa Boletini, Zejnel bej Begolli, Riza bej Gjakova, Dervish bej Mitrovica, Hasan Hysen Budakova, Ajdin Draga, Qazim Bej Peja dhe Naxhi Tahi nga Jeni Pazari. Gjeneral Deralla

³⁵³Dr.Arsim Sinani, ”Revista Diskutime”, Nr. 11.maj.2014, faqe.5

³⁵⁴ Prof.Asoc.Dr.Zaho GOLEMI, Shef Departamenti në Akademinë e Forcave të Armatosura, ”Revista Diskutime”, Nr. 11.maj.2014, faqe.9

³⁵⁵ Prof.Asoc.Dr.Zaho GOLEMI, Shef Departamenti në Akademinë e Forcave të Armatosura, ”Revista Diskutime”, Nr. 11.maj.2014, faqe.9

gjatë veprimtarisë së tij atdhetare për çështjen kombëtare, në kuvende, në besëlidhje, në pajtim të gjaqeve apo çështje të tjera kombëtare thoshte: "Jena shqiptarë, s'e duam të huajin në tokat tona, vetëm lufta me mend e më pushkë ka me na qitë në dritë".³⁵⁶ Duhet të kemi parasysh se Deralla i qëndroi deri në fund besnik qeverisë së Ismail Qemalit. Kjo më së miri shihet kur më 1913, Ismail Qemali u nis në krye të delegacionit të qeverisë shqiptare, ku bënë pjesë: Isa Boletini e Luigj Gurakuqi. Deri në këtë kohë, qeveria e përkohshme e Vlorës në krye me Ismail Qemalin, përveç delegacionit shqiptar që mbante pranë Konferencën e Ambasadorëve në Londër, dërgoi paralelisht edhe dy delegacione të tjera, një në Romë dhe një në Vjenë. Qëllimi i dërgimit ishte që të siguronin përkrahjen e Italisë dhe Austro-Hungarisë, që të mbronin çështjen shqiptare ndaj gjenocidit që ushtronin ushtritë serbo-malazeze në Shqipërinë verilindore dhe ato greke në popullsinë çame.³⁵⁷

Shtëpia e Mehmet Pashë Derallës në Tetovë ishte vend i takimeve të krerëve të kombit shqiptar, si Hasan Prishtina, Sali Gjuka, Bedri Pejani, Bajram Curri, Isa Boletini, Mithat Frashëri, Hamdi bej Ohri. Së bashku me djalin Halimin marrin pjesë në Kuvendin e Gjilanit në vitin 1910, për përkrahjen e kryengritjes së Kaçanikut dhe udhëheqësin e saj, Idriz Seferin. Po ashtu udhëtuan për në Serbi dhe kërkuan nga Pashiqi ndihmë ushtarake për kryengritjen që po përgatishnin Kosova dhe trevat e tjera lindore në pranverën e vitit 1912. Ishin prezentë në Kuvendin e Junikut të mbajtur më 21-25 Maj 1912.³⁵⁸

Ideali i Gjeneral Mehmet Pashë Derallës ishte atdheu dhe kombi, dhe çdo minutë të jetës së tij kaloi duke kontribuar për çështjen kombëtare, ndërsa sakrifica e tij ishte ideali kombëtar.

³⁵⁶ Prof. Asoc.Dr.Zaho GOLEMI, Shëf Departamenti në Akademinë e Forcave të Armatosura, "Revista Diskutime", Nr. 11.maj.2014, faqe.9

³⁵⁷ Prof Dr.Vehbi Xhemali USHT-Tetovë "Dielli Online", Mehmet Derralla, Ministri i parë në Qeverinë e Vlorës "

³⁵⁸ Mustafë Tetovën, "Ministri Shqiptar që është harruar nga shteti shqiptar "Shqipmedia", Nëntor-.2014

Rridhte nga një familje, e cila kishte bazë të mirë ekonomike, tradita atdhetare, një kulturë fisnore që kontribuoi për çështjen kombëtare. Duhet të themi se në këtë kohë të merresh me çështje ushtarake ishte një privilegj, për arsye se kësaj figure, siç ishte Deralla, i duheshin shtetit dhe kombit shqiptar, pasi që përvojat që gjeneral Deralla i mori në Perandorinë osmane, i barti te ata luftëtarë trima shqiptarë që me zemër ishin luftëtarë të denjë, por që mungonte strategjia luftarake. “Të gjitha gradat ushtarake i mori me mençuri, korrektësi e pasion, për këtë arsye bie në sy për të mirë dhe emërohet ushtar me perspektivë dhe fitoi të drejtën për Shkollën e Lartë (Akademi e Dytë) të Shtatmadhorisë në Stamboll, ku demonstroi dije, aftësi profesionale, mbajti raporte të moralshme në detyra e shoqëri, si dhe prirje drejtuesi e organizator ushtarak.³⁵⁹

Propozimi i Isa Boletinit për Mehmet Pashë Derallën

Gjeneral Deralla ishte luftëtar i vetëm, i cili udhëhoqi me përkujdesje dhe me përkushtim qëndresën shekullore kundrejt sulmeve serbo-malazeze, të cilat synonin pushtimin e Shqipërisë Veriore. “Ky së bashku me shumë luftëtarë shqiptarë bllokuan forcat serbe ndërmjet Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi. Në rrugë e sipër për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, Ismail Qemali dhe Hasan Bej Prishtina gjatë udhëtimit për në Vlorë më 1912, porositën që të njoftohej edhe gjeneral Deralla i cili përfaqësonte qarkun e Prizrenit, rrethin e Tetovës, Prizrenit, Gjakovës dhe të Lumës së Kukësit, për ngjarjen e madhe që do ndodhte në Vlorë, një ngjarje e madhe e cila pritej me gjenerata e gjenerata nga populli shqiptar, “Kuvendi i Vlorës”, që pasoi me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, e cila ndodhi më 28 nëntor 1912.

³⁵⁹ Zaho Golemi Aurora Golemi, “Themeluesi i Ministrisë së Luftës dhe fryma e re Kombëtare Shqiptare (Mehmet Pashë Derralla,”Revista Dikutime”, Nr. 11, maj 2014, Faqe.10.

Në këtë kuvend merrnin pjesë përfaqësues nga të gjitha viset shqiptare, ndërsa ministër i Luftës i qeverisë së kryesuar nga plaku i mençur e mjekërbardhë i flamurit, Ismail Qemal Vlora, u caktua Mehmet Pashë Deralla. Gjeneral Deralla u propozua në këtë funksion nga burri dhe plaku i shquar i Kosovës Isa Boletini.³⁶⁰ Në mbledhjen e radhës që u bë në dhjetor, Ismail Qemali filloi të kërkonte kushte dhe kritere nga ministrat e tij. Këtë e bëri që të jenë të kënaqur Evropa, në njërin anë, dhe Stambolli në anën tjetër, me një fjalë të jenë ministra që i njeh edhe Evropa dhe bota e jo vetëm shqiptaria. Në votimin e parë, gjeneral Deralla nga Tetova fitoi 42 vota, duke mbetur pas Luigj Gurakuqit me 54 vota dhe Myfit Bej Gjirokastra (Libohova), me 52 vota.³⁶¹

Kontributi i gjeneralëve turq në Ushtrinë Shqiptare

Duhet nganjëherë të themi se disa pushtues lanë pas vete edhe përvoja që mund t'i quajmë edhe të mira. Në rastin tonë, ku në fokus kemi gjeneral Deralla, është për ta përmendur se përvojën më të madhe e mori në Perandorinë Osmane, përvojë kjo që i shërbeu në organizimin e ushtrisë shqiptare dhe formimin e saj.

“Në këtë kohë, pas vitit 1912, Shqipëria nuk kishte asnjë mundësi që të përgatiste ushtarakë, oficerë dhe nënoficerë në vend. Kjo ndodhi për arsye të thjeshtë se në këtë kohë Shqipëria nuk kishte ushtri dhe as shkollë ushtarake kombëtare, në të cilën të arsimonte dhe të formonte ushtarakë, të cilët do të shërbenin për qëllime mbrojtëse të vendit dhe të popullit shqiptar.³⁶²

³⁶⁰ Zaho Golemi Aurora Golemi ”Themeluesi i Ministrisë së Luftës dhe fryma e re Kombëtare Shqiptare (Mehmet Pashë Deralla, ”Revista Dikutive”, Nr. 11, maj-2014, Faqe. 13.

³⁶¹ Po aty, faqe 14.

³⁶² Prof.Dr.Proletar HASANI, Dr.Edit BREGU, ”Plejada e Oficerëve Shqiptarë të Shkollës ushtarake turke, gjeneral Mehmet Pashë Deralla”, “Revista Diskutive Nr.11, 2014 faqe.18

“Nga ajo ushtri dolën dhe u vunë në shërbim të ushtrisë kombëtare shqiptare përafërsisht 70 oficerë dhe 150 nënoficerë, ku nga këto figura u shkruan emrat e shumë drejtuesve më të lartë, por edhe të komandantëve të njëjve kryesore ushtarake të atyre viteve”.³⁶³

Për informacion duhet t’i përmendim disa personazhe historike që lanë gjurmë në historinë e kombit shqiptar: Ismail Qemali (Vlora), gjeneral brigade Mehmet Pashë Deralla – Tetova (1843-1919), Ali Shefqeti (Shkupi), gjeneral brigade Esat Pashë Toptani (1863-1920), Ali Riza Kolonja (1880-1930), kolonel Selaudin Said Shkoza, major Mustafa Maksuti Shehu (1881-1936), Kapiten Yija Dibra (1885-1924), nënkolonel Shefik Kosturi, kolonel Ismail Haki Tatzati (1887-1945), nënkolonel Rexhep Shala, gjeneral divizioni Xhemal Aranitasi (1886-1961), Aqif Përmeti (1884-1945).³⁶⁴

Fjalët e mbesës së Mehmet Pashë Derallës

Ka shumë dokumente që flasin për familjen Deralla e në veçanti për gjeneralin e parë të Ushtrisë shqiptare, Mehmet Pashë Deralla, që, njëherësh ishte ministër i parë i Mbrojtjes në Qeverinë e Ismail Qemalit, shprehet Valdete Deralla, e cila kishte lindur në Tetovë e që për arsye politike, kanoset nga pushteti i atëhershëm, ishte shpërngulur nga Tetova në moshë të re në Shqipëri, më pastaj migroi në Austri.³⁶⁵

“Mbas kapitullimit të Gjermanisë dhe kthimit në Tetovë, xhaxhai (Gajuri) u dënua për vdekje, kurse babai u fsheh në një nga fshatrat e Kosovës, pasuri e derallajve në kohën e Perandorisë osmane në fshatin Kotlinë (ku qëndroi rreth 6 muaj rreth vitit 1947, më pastaj u kthye në Shkup dhe u arrestua nga policia sllave që në atë kohe quhej Ozna. Kjo

³⁶³ Po aty, faqe. 18.

³⁶⁴ Po aty, faqe,19

³⁶⁵ Ismail Arslani “Me Ismail Qemalin ishte Mehmet Pashë Deralla”, ”Revista Diskutime”, nr. 11, Maj 2014, Faqe.24

tregon se si në moshën 6 vjeçare, babai i saj (Hyseni) dënohet si një bir i një gjenerali me 16 vjet burg nga sistemi komunist.³⁶⁶

Pas burgosjes në shtëpinë e familjes Deralla, në Shkodër jetonte motra e Luigj Gurakuqit, e cila në një moment të vështirë, kur kishte mësuar se do të kontrollohej nga sistemi komunist, nga frika e dogji bibliotekën e Luigj Gurakuqit, ndërsa Valdetja arriti të shpëtonte një pjesë të dokumenteve pa u djegur, ku kishte material për Pavarësinë e Shqipërisë, si dhe për zgjedhjen e Mehmet Derallës, ministër i luftës, me vota të rregullta në Kuvendin e Vlorës. Deralla ishte organizator ushtarak, shef i shtabit të Vokshit në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe kur ishte fjala për të mbrojtur Ulqinin, u caktua komandant dhe së bashku me 4000 ushtarë fituan betejën me turqit, mirëpo flota evropiane ia humbi fitoren dhe Ulqini u mor nga malazezët.³⁶⁷

“Sipas mbesës së Derallës, figura e gjeneral Mehmet Derallës është lënë në harresë nga komunizmi, bile nuk përmendet fare në dokumentet e kësaj kohe, si dhe nga sistemet pas komunizmit nuk është bërë diçka e veçantë, ndonëse ka merita që busti i tij të ishte diku në mes të Tiranës.”³⁶⁸

Gjeneralët si Deralla e shumë figura të lënë anash nga shoqëria, janë figura që bartin gjithë atë bagazh mbi supet e veta dhe prestigjin kanë të fituar me mund, sakrificë, përgjegjësi në punë, seriozitet ushtarak, qëndrueshmëri në detyrë dhe në shërbim të atdheut në çdo moment dhe në çdo kohe.

Ata nuk duhet të ishin njerëzit që renditen pas pushtetit (partive politike), sepse kanë një dinjitet të pastër dhe janë figura që i shërbejnë atdheut, përndryshe duhet të bëhen servilë të politikanëve dhe duhet t’u

³⁶⁶ Valdet Deralla në emisionin “Forum “, Tema “Mehmet Pashë Deralla”
<https://www.youtube.com/watch?v=GQi4Lj6-j0o> , Prill 11, 2014

³⁶⁷ Po aty

³⁶⁸ Po aty.

shërbejnë servilëve që nuk e kanë për qëllim atdheun, por përfitimet materiale dhe vetjake.

“Është për të ardhur keq fakti se Mehmet Pashë Deralla ishte ministër i parë shqiptar dhe pa dyshim është nga më të harruarit, ndonëse ende mund të ketë njerëz që e njohin kontributin për ushtrinë kombëtare shqiptare, me një bagazh të pastër në shtet-formimin e ushtrisë shqiptare”.³⁶⁹

Pas një shkëputjeje të gjatë, që nga mosha dyvjeçare, Valdete Deralla ëndërronte të kthehej në vendlindje dhe tregon vështirësitë që kishte hasur gjatë vitit 1989 kur kishte marrë një vizë për në Turqi e që me shumë vështirësi mori edhe një vizë transiti për në Jugosllavinë e atëhershme, me qëllimin e vetëm për të ardhur në Tetovë.³⁷⁰

“Kurrë nuk do t’i harroj ato ditë kur unë do të vija në Tetovën e gjeneral Derallës, në Tetovën të cilën nuk e mbaj mend pas largimit, ku u derdh gjak, u bë një sakrificë e paraardhësve të mi dhe mezi prisja të vijë ajo ditë që do të kthehesha në Tetovë. Nga nostalgjia për këtë vend, një ditë e pyeta babanë “nëse arrij në vendlindje, në cilin derë do të duhej të trokas. Ai m’u përgjigj: “Shko ti moj bijë në Tetovë, se vetë tetovarët kanë për të të gjetur ty”.³⁷¹

Këto fjalë që i dëgjova nga babai im ishin një lehtësim i madh për mua, megjithatë babai (Hysen Deralla) e kishte vërejtur një dozë dyshimi tek unë, ndër shumë këshilla që m’i dha ishte edhe ajo: “Mos harro, duhet të shkosh në fshatin Gradec, që gjendet mes Tetovës dhe Gostivarit, se atje

³⁶⁹ Prof.As.Dr.Elmas Leci. <http://www.forumishqiptar.com/threads/40501->

“Gjeneralet-fatkeqe që i shërbyen-Ushtrisë-Shqiptare.

³⁷⁰ Ismail Arslani. <http://gazeta55.al/me-ismail-qemalin-ne-vlore-ishte-edhe-mehmet-pashe-derralla-nga-tetova/18-11-2012>

³⁷¹ Po aty.

ke një lagje të tërë, me dyzet familje, që i përket trungut të familjes Deralla.³⁷²

Valdete Deralla vazhdon: "Na tregonte shpesh babai se pasuria e të parëve tanë, Hasan Pashë Deralla dhe Mehmet Pashë Deralla ka qenë aq e madhe, sa që është numëruar ndër tri më të mëdhatë në trojet etnike shqiptare, bashkë me atë të Libohovëve të Gjirokastrës dhe Begollëve të Pejës, dhe kjo pasuri ishte vënë në shërbim të çështjes kombëtare, gjë që dëshmohet me të gjitha argumentet historike.³⁷³

Rrëfimet e Berat Gajur Derallës

Berat Deralla është i biri i Gajur Derallës, nipi i Mehmet Pashë Derallës, i cili sakrifikoi një jetë të mirë që e bënte në Amerikë dhe u kthye në vendin e lindjes së paraardhësve të tij, që gjithë jetën ia kushtuan çështjes kombëtare dhe shtetformimit të tij. U kthye në vendin e lindjes, në Tetovë, për të nxjerrë në sipërfaqe eshtrat e gjyshit të tij, Mehmet Pashë Deralla dhe për t'i rivarrosur ashtu siç ai e meriton, me ceremoni shtetërore, në mënyrën se si varroset një gjeneral i cili gjithë jetën ia kushtoi shtetit e kombit shqiptar, në formimin e institucionit më të lartë shtetëror, atë të Ministrisë së Mbrojtjes.

Në një intervistë dhënë në emisionin "Analizë" të TV2 nga Gostivari thekson: "Postin e ministrit të Mbrojtjes nuk e mori në fillim kur edhe u propozua, por ky propozim erdhi nga Isa Boletini, pasi që paraprakisht ishte propozuar Isa Boletini në këtë post, por ky ishte deklaruar: "Unë nuk e meritoj këtë post, por personi që e meriton atë është pikërisht Mehmet Pashë Deralla."³⁷⁴

³⁷² Po aty.

³⁷³ Ismail Arslani.<http://gazeta55.al/me-ismail-qemalin-ne-vlore-ishte-edhe-mehmet-pashe-derralla-nga-tetova/18-11-2012>.

³⁷⁴ Tv2 Gostivar, "Familja Deralla"

<https://www.youtube.com/watch?v=1zwQ9JpFDs8>, Mar-17-2014.

“Mehmet Pashë Deralla e deshi atdheun, po ashtu e mbronte atë nga të gjitha anët ku kishte shqiptarë e veçanërisht Pollogun që ishte vendlindja e tij. Gjithë veprimtarinë e tij ushtarake në Mal të Zi, Kosovë, Shkupi e Shqipëri, i kushtoi edhe për të ndihmuar fshatarët në aspektin ekonomik, ngase vetë ai ishte në gjendje të mirë ekonomike e financiare.³⁷⁵

Harabati Baba Teqe është një vend në Tetovë ku u mbajtën takime e mbledhje të patriotëve dhe personaliteteve të njohura shqiptare. Aty u mbajt edhe mbledhja e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Më 13 Gusht 1912, në këtë vend u mbajt mbledhje, ku morën pjesë 56 delegatë, si: Isa Boletini, Luigj Gurakuqi, Ismail Qemali, Hasan Prishtina dhe shumë bashkëluftëtarë të tjerë, me ç’rast edhe e ngritën Flamurin kombëtar në Kalanë e Shkupit³⁷⁶

Po ashtu, gjithnjë në bazë të fjalëve të tij, varri i Mehmet Pashë Derallës gjendet diku në Harabati Baba Teqe, ku mendohet se e ka varrosur djali i tij Halimi, mirëpo duhet një punë hulumtuese, për arsye se është bërë përzjerja e gurëve të varreve në kohën e komunizmit. Ka edhe një shqetësim nga familja, se nuk është duke u bërë mjaft në zbardhjen e figurave siç është Deralla e shumë figurave të tjera të rëndësishme.³⁷⁷

“Është e qartë vetëm sakrifica e tyre deri në flijim sublim, që rëndon mbi themelet e shtetit shqiptar (Republika e Shqipërisë), atyre që nuk e kanë edhe interesimin më të vogël për këtë figurë të rrallë të kombit shqiptar. Është për t’u habitur fakti që as në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit nuk mund ta gjesësh edhe një foto për këtë figurë që dha një kontribut të madh në këtë ngjarje të madhe historike.³⁷⁸

³⁷⁵ Po aty.

³⁷⁶ Po aty.

³⁷⁷ Po aty.

³⁷⁸ Dr.Arsim Sinani, ”Prolog për Derallajt, Neoshqiptarizmi i Mehmet pashë Derallës”, ”Revista Diskutime”, ”Diskutime Rikujtesë”, 23-Shtator-2014.

Është bërë një padrejtësi ndaj figurave si Deralla, duke marrë parasysht se e sakrifikoi veten, shkriu të gjithë pasurinë, u arrestua, u burgos, u persekutua, iu fshinë regjistrat e ekzistimit, u përzu nga vendlindja e tij, vetëm e vetëm që të mos njihet kontributi i tij për çështjen kombëtare.

“Çka duhet të bëjnë këta burra si Deralla e shumë trima të tjerë më shumë sesa që dhanë jetën e tyre, vetëflijuan familjet e tyre, për të lartësuar me trupin e tyre shtetin shqiptar.”³⁷⁹

“Sipas prof. Arsim Sinanit, “Mehmet Pashë Deralla mbetet një monument i madh i kombit shqiptar, një figurë që kurrë nuk pranoi të bëhet vasal, por e vazhdoi idealin e tij, edhe pse ishte braktisur e i vetmuar në veprimin e tij. Jo vetëm që njomi themelet e atdheut tonë, që Shqipëria të jetë e pavarur, të lulëzojë, të gëzojë pavarësinë. I tillë ishte Mehmet Pashë Deralla dhe e gjithë familja Deralla që nuk u ndalën dhe me vetëdije pranuan flijimin, por, njëkohësisht edhe pavdekësinë”.³⁸⁰

Padyshim që historitë e popujve nganjëherë lidhen në bazë të familjeve të mëdha, ato kanë qenë ndër barrikatat e para ndaj çdo rrebeshi, pastaj janë përballur me hordhi armiqsh gjithfarësh, duke mbrojtur fillimisht pragun e shtëpisë, pastaj edhe nderin e qytetit, shtetit dhe kombit.

“Padyshim, në vargun e këtyre familjeve të mëdha, dera e Derallajve zë vendin e saj të merituar në historinë e kombit shqiptar. Ndër figurat e mëdha të kësaj dere, padyshim se është Mehmet Pashë Deralla, i cili do të sakrifikonte gradat dhe privilegjet e afuara nga Porta e Lartë, duke u vënë në shërbim të atdheut për pavarësinë e trojeve etnike arbërore.”³⁸¹

³⁷⁹ Po aty.

³⁸⁰ Po aty

³⁸¹Eugen Shehu “Halim Derralla –Personalitet i shquar i Levizjes Autonomiste Shqiptare”, <http://www.lajmishqip.com/?p=1475,28-11-2006>

Disa nga thëniet e Derallës që mbeten legjenda

“Dashuria për Atdhe është më e madhja nga të gjitha, ajo qëndron mbi çdo dashuri”. “Jena shqiptarë, se duam të huajin në vatrat tona, vetëm lufta me mend e me pushkë ka me na qitë n’dritë”. “Vendin e Osmanlive po përpiqen t’na zanë Serbët, e ne nuk do t’i lëshojmë për së gjalli”. “Pa qëndresën e armëve tona nuk mund të arrihej në fitimin e Kuvendit Kombëtar, në 28 Nëntorin e Madh të Kombit tonë, se pa besën trimëritë dhe pushkët e luginave të Moravës, të Vardarit e të Drinit, nuk do të kishim pavarësi kombëtare e ndoshta as jetë shqiptare si popull”.

“Kufijtë që neve i ndikojmë janë ata që do të shkojnë gjatë një vije demarkacioni që nisin nga kufijtë e tanishëm të mbretërisë malazeze e që përfshinë qytetet e Pejës, Mitrovicës, Prishtinës, Shkupit e Manastirit, deri në kufijtë e tanishëm në Prevez”. “Amanet burra katër shtyllat e kombit, se janë një bashkësi me një gjuhë, një gjak, një flamur dhe një histori”.

Këngë kushtuar Mehmet Pashë Derallës:

“O Mehmet Pashë Deralla, rritur me përsesh baruti, të kishte fjala dhe palla, lisi tyre je te supi, të këndon Labëria siç këndon për Gjon Lekën, të këndonte historia kur për Nënë të japin jetën, po ku i rri valles së rëndë o Mehmet Pashë Tetovari, nëna prap të don në këmbë, tundu dhe çohu nga varri”.

Përfundim

Në bazë të kësaj që u shtjellua, erdha në përfundim se Mehmet Pashë Deralla ishte një figurë shumë e njohur e historisë së popullit shqiptar, i cili tërë jetën e tij ia kushtoi çështjes së kombit shqiptar, duke arritur që të mbetet ndër emrat më të njohur të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Përveç detyrës që ushtronte, ai u angazhua edhe në çështjen e organizimit të ministrisë së parë të mbrojtjes. Edhe pse gjatë periudhës së komunizmit, kontributi i tij nuk u vlerësua, prapë se prapë ai mbeti një nga ikonat e popullit shqiptar ndër breza të tërë. Ai përveç që nuk u përmend gjatë kësaj periudhe, në disa raste ai edhe u fshi nga disa fotografi, vetëm që të jetë në hije të kohës.

Një kontribut të madh në zbardhjen e kësaj figure ka dhënë edhe prof. Arsim Sinani, i cili ka bërë shumë për këtë figurë të shquar të çështjes kombëtare shqiptare, ku në vazhden e shumë përpjekjeve të tij është edhe gjetja e varrit të këtij heroit kombëtar dhe rivarrosjen e eshtrave, ashtu siç e meriton një gjeneral i përmasave çfarë ishte Mehmet Pashë Deralla.

Duhet të kujtoj edhe një herë se ishte nga pak figurat e njohura të kombit shqiptar që fiku edhe pasurinë e fundit nga familja e tij, vetëm për çështjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe në përgjithësi çështjes kombëtare. Lidhur me këtë, ai arriti që të mbetet në kujtesën e gjithë shqiptarëve me breza të tërë dhe të jetë një simbol i atdhedashurisë. Edhe pse mbeti një kohë të gjatë nën hijen e pluhurit të arkivave dhe kujtesës, më në fund është në rrugë të mbarë zbardhja e një personaliteti çfarë është Mehmet Pashë Deralla.

Bibliografia

1. Dr. Arsim Sinani, "Revista Diskutime", Nr.11, maj 2014, fq. 5
2. <http://www.arkivalajmeve.com/Tre-ministra-shqiptare-te-Mbrojtjes-bashke-per-te-nderuar-ministrin-e-Luftes>.
3. Prof.Asoc.Dr.Zaho GOLEMI, Shef Departamenti në Akademinë e Forcave të Armatosura, "Revista Diskutime", Nr.11, maj2014, fq.9
4. Prof.Asoc.Dr.Zaho GOLEMI, Shef Departamenti në Akademinë e Forcave të Armatosura, "Revista Diskutime", Nr.11, maj 2014, fq. 9
5. Prof. Dr. Vehbi Xhemali, USHT-Tetovë, "Dielli Online", Mehmet Deralla ministri i parë në qeverinë e Vlorës "
6. Mustafë Tetova, "Ministri shqiptar që është harruar nga shteti shqiptar, "Shqipmedia", Nëntor 2014
7. Prof. Dr. Proletar HASANI, Dr. Edit BREGU, "Plejada e Oficerëve Shqiptarë të shkollës ushtarake Turke, Gjeneral Mehmet Pashë Deralla", "Revista Diskutime ", nr. 11, 2014, fq.18
8. Ismail Arslani "Me Ismail Qemalin ishte Mehmet Pashë Deralla", "Revista Diskutime", nr.11, maj 2014, fq.24
- 9.Valdet Deralla në emisionin "Forum", tema "Mehmet Pashë Deralla" <https://www.youtube.com/watch?v=GQi4Lj6-j0o> , Prill 11, 2014
- 10.Prof.As.Dr.ElmasLeci.<http://www.forumishqiptar.com/threads/40501-Gjeneralet-fatkeqe-qe-i-sherbyen-Ushtrise-Shqiptare>.
11. Ismail Arslani. <http://gazeta55.al/me-ismail-qemalin-ne-vlore-ishte-edhe-mehmet-pashe-derralla-nga-tetova/18-11-2012>

12. Ismail Arslani. <http://gazeta55.al/me-ismail-qemalin-ne-vlore-ishte-edhe-mehmet-pashe-derralla-nga-tetova/18-11-2012>.
13. Tv2 Gostivar "Familja Deralla",
<https://www.youtube.com/watch?v=1zëQ9JpFDs8,Mar-17-2014>.
14. Dr. Arsim Sinani, "Prolog për Derallajt, Neoshqiptarizmi i Mehmet pashë Derallës", "Revista Diskutime ", "Diskutime Rikujtesë", 23-Shtator-2014.
15. Eugen Shehu "Halim Deralla –Personalitet i shquar i lëvizjes autonomiste shqiptare", <http://www.lajmishqip.com/?p=1475,28-11-2006>
16. <https://www.facebook.com/media/set/?set=a.1585150798366577.1073741834.1463144503900541&type=3>
17. Bisedë me Berat Derallën, djalin e Gajur Derallës, Tetovë 2014
18. Bisedë me Genc Derallën, nipin e Halim Derallës, dhjetor 2014, Tetovë
19. Abstrakte dhe ndjekja e punimeve të Konferencës shkencore kombëtare "102 vjet shtet shqiptar e më pastaj. Çështja shqiptare dhe Derallajt", 06-07 dhjetor 2014, Shkolla amerikane Uillson, Tetovë, organizuar nga Qendra për marrëdhënie ndërkombëtare dhe studime ballkanike me partnerët.